



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:123614

Datë: 16.08.2024

Numri i dokumentit: 06057414

P.nr.141/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, me bashkëpunëtoren profesionale, Kaltrina Sfarqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit: L.L., për shkak të veprave penale: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 3, pika 3.1, lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 të KPRK-së, veprës penale: Kanosja nga neni 181, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, si dhe Kanosja nga neni 181, paragrafi 2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.710/2024 të datës 07.05.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 17.07.2024, në prezencë të prokurores së shtetit Albana Parduzy, të pandehurit L.L., mbrojtësit të pandehurit Av.A.A., të dëmtuarve H.S. dhe A.S., si dhe dëshmitarit R.L., me datë 18.07.2024 shpalli publikisht, ndërsa me datë 16.08.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

L.L., nga i ati R....., e ëma B....., e vajzërisë K....., i lindur me datë, në M....., me vendbanim në Sh....., Rr.”.....”, M....., në bashkësi jashtëmartesore, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

1.

SEPSE:

Me datë, rreth orës, në rrugën “.....”, në lagjen Sh....., M....., saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuares H.S. – viktimës së ndjeshme, me të cilën janë në bashkësi jashtëmartesore, në atë mënyrë që pas një debati që e kishin lidhur me rrjetin social instagram, ku fillimisht e fyen dhe pastaj e godet me grushte në fytyrë, me shuplaka dhe e godet prapa në kokë, me të cilat veprime të dëmtuarës i shkakton lëndim të lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin, të cilat paraqesin: gërvishje lëkurore në regjionin e fytyrës, në regjionin e qafës, në regjionin e laprës së veshit të majtë, në regjionin e parakrahut të dorës së majtë.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 3, pika 3.1, lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 të KPRK-së.

2.

SEPSE:

Me datë, rreth orës, në rrugën “.....”, në lagjen Sh....., M....., saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri me dashje me fjalët serioze e kanos të dëmtuarën H.S. – viktime e ndjeshme se do ta privoj nga jeta, me të cilën janë në bashkësi jashtëmartesore, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin në mes tyre lidhur me rrjetin social instagram, ku pasi që e fyen me fjalët “ti je kurv, qysh o fol me burra tjerë”, e thërret në telefon vëllaun e të dëmtuares A.S. dhe ju drejtohet me fjalët “motra jote po fol me djem, ska me dal e gjallë prej kësaj shtëpie, ko me myt krejt”, me të cilat veprime tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

3.

SEPSE:

Me datë, rreth orës, në rrugën “.....”, në lagjen Sh....., M....., i pandehuri përmes telefonit e kanos të dëmtuarin A.S. se do ta privojë nga jeta, pasi që paraprakisht e kishte kanosur dhe kishte ushtruar dhunë fizike ndaj motres së tij, ku i thotë për H..... se “motra jote po fol me djem, s’ka me dal gjallë prej kësaj shtëpie, ko me myt krejt”, në momentin që i dëmtuari i drejtohet me fjalët “po vi”, i pandehuri i thotë “mos hajde se nuk del i gjallë as ti”, me të cilat veprime tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181, paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, si dhe 185, par.3, pika 3.1, lidhur me par.1, nën-par 1.4 dhe 181, par.4, lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe neni, 358, 364, 459, të KPP-së, i:

S H Q I P T O N

- I.** Të pandehurit L.L., për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 3, pika 3.1, lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 të KPRK-së, i shqipton **DËNIM ME BURGIM** të kushtëzuar në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

- II.** Të pandehurit L.L., për veprën penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, i shqipton **DËNIM ME BURGIM** të kushtëzuar në kohëzgjatje prej një (1) viti.

- III.** Të pandehurit L.L., për veprën penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 2 të KPRK-së, i shqipton **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej pesqindë (500) euro.

Në pajtim me nenin 76 të KPRK-së, të pandehurin L.L. e:

G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM UNIK ME BURGIM** të kushtëzuar në kohëzgjatje prej gjashtëmbëdhjetë (16) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

- II.** Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe atë nga data 25.04.2024 deri me datë 18.07.2024.

- III. Me DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej pesqindë (500) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet që t'a paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- IV. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar nga gjykata, gjykata do të veprojë sipas nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, me zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim, ku 20 (njëzetë) euro të dënimit me gjobë llogariten me 1 (një) ditë burgim
- V. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), po ashtu edhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- VI. Pala e dëmtuar H.S. dhe A.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A R S Y E T I M

Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.710/2024 të datës 07.05.2024, ndaj të pandehurit L.L., për shkak të veprave penale: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 3, pika 3.1, lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 të KPRK-së, veprës penale: Kanosja nga neni 181, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, si dhe Kanosja nga neni 181, paragrafi 2 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 16.05.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e prokurorit të shtetit Shaqir Sedolli, të dëmtuarve H.S. dhe A.S., mbrojtësit të viktimave Isa Aruqi, të pandehurit L.L. dhe mbrojtësit të pandehurit Av.A.A..

I pandehuri, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka deklaruar se në raport me pikën e

parë dhe të dytë të aktakuzës deklarohet i pa fajshëm, ndërsa e pranon fajësinë për pikën e tretë të aktakuzës.

Gjykata ka miratuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 2 të KPRK-së, ndërsa ka vendosur që shpallja e aktgjykimit lidhur me këtë pikë të bëhet në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata me datë 17.07.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në praninë e prokurores së shtetit Abana Parduzy, të pandehurit L.L., mbrojtësit të pandehurit Av.A.A., të dëmtuarve H.S. dhe A.S., si dhe dëshmitarit R.L..

I pandehuri, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale sipas aktit akuzues.

Prokurorja e shtetit Albana Parduzy lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës. Gjykatës i ka propozuar që të njejtin ta shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit duke marr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, si dhe duke marr parasysh rrethanat rënduese ashtu që i pandehuri me veprimet e tij ka bërë lëshime të qëllimshme ndaj të dëmtuarës tek e cila ka shkakuar ndjenjën e frikës, rrezikshmërisë personale, sulm fizik dhe presion psikik, faktin se kemi të bëjmë me viktimë të ndjeshme dhe se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

E dëmtuara H.S. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë, duke i propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shqiptojë një dënim sa më të butë, pasi që i kanë rregulluar raportet, se nuk ndihet e rrezikuar nga i pandehuri dhe nuk i bashkangjitet ndjekjes penale.

I dëmtuari A.S. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 16.05.2024, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, nuk parashtron kërkesë pasurore juridike dhe nuk i bashkangjitet ndjekjes penale.

Mbrojtësi i të pandehurit L.L., Av.A.A. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës.

Mbrojtësi ka deklaruar se i pandehuri dhe pala e dëmtuar vazhdimisht kanë deklaruar se problemet e mundshme i kanë rregulluar, situata e cila ju ka ndodhur rezulton të jetë si pasojë e një keqkuptimi në rrjete sociale, si dhe me aktvendimin C.nr.2035/24 të datës 04.07.24 të pandehurit i është ndërprerë urdhëri mbrojtës, sipas kërkesës së të dëmtuarit. Gjykatës i ka propozuar që të ketë parasysh pranimin e fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike, rregullimit të raporteve të pandehurit me të dëmtuarën, ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë një dënim me kusht.

I pandehuri L.L. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit. Gjykatës i ka propozuar që t'i shqiptoj një dënim me kusht për arsye se dënimi me burgim efektiv e vështirëson gjendjen e tij ekonomike, se është vepruar për veprat penale, se koha e kaluar në paraburgim ka qenë një mësim për të, se i kërkon falje të dëmtuarës dhe premtion se nuk do të përsërisë më veprën penale.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri L.L. në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit, i datës, Procesverbal i marrjes në pyetje të dëmtuarës H.S. i datës ..., Raporti i Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë, Procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitarit R.L. i datës, Procesverbali i marrjes në pyetje të A.S. i datës, Procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarit L.L. i datës, Raporti i oficerit i datës, Foto-albumi.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë është bërë nga i pandehuri në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata i'a kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mund të shfrytëzojë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humbë mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka

vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri L.L. është përgjegjës për veprat penale për të cilën akuzohet: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 3, pika 3.1, lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 të KPRK-së, veprës penale: Kanosja nga neni 181, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, si dhe Kanosja nga neni 181, paragrafi 2 të KPRK-së.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së, e si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, dashjen e të pandehurit, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të në këtë veprë penale, rrethana të tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se i pandehuri ka treguar sjellje të mira, ka bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti, keqardhjen e shprehur para gjykatës për rastin e ndodhur. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprat penale.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, dënimi i shqiptuar, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Shpenzimet procedurale:

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, në pajtim me nenin 459 të KPP-së, duke e udhëzuar palën e dëmtuar H.S. dhe A.S., në kontest të rregullt civil, pasi që të njëjtit në seancën e shqyrtimit gjyqësor kanë deklaruar se nuk paraqesin kërkesë pasurore juridike.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 459 të KPPK-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.141/2024, datë 16.08.2024

Bashkëpunorja profesionale
Kaltrina Sfarqa

Gjyqtarja e vetme gjyqësore
Marigona Lajqi

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.